



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:183887

Datë: 13.02.2024

Numri i dokumentit: 05323677

KPPP.nr. 523/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “Klajger Konstruksion” Sh.P.K., dega në Kosovë, me numër unik identifikues 811347386 dhe seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit T.H., avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 290/2020, i lejuar me datë 07.12.2020, nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 31.01.2024 në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, me datë 05.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 290/2020, i lejuar me datë 07.12.2020, nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 290/2020, i lejuar me datë 07.12.2020, nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, MBETET NË FUQI.
- III. DETYROHET debitori Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që, në emër të shpenzimeve për përfaqësim në seancë dëgjimore, t’ia paguaj kreditorit “Klajger Konstruksion” Sh.P.K., dega në Kosovë, shumën prej ERU 270.00 (dyqind e shtatëdhjetë Euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 06, e datës 30.03.2020, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 290/2020, të datës 07.12.2020, me të cilin është urdhëruar debitori Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 101,052.210 me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se me kreditorin kanë pasur kontratë publike kornize, në të cilën kontratë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese, përkatësisht është përcaktuar edhe vlera e projektit në lartësi prej EUR 700,000.00, si vlerë fikse e cila nuk do të nënshtrohet ndryshimeve. Ndërsa, ka shtuar se kreditori ka bërë tejkalime të shpenzimeve të kryerjes së shërbimeve të pa porositura nga debitori ndë në asnjë rast nuk e ka informuar debitorin. Me tej, ka theksuar se nuk ka pasur pëlqim, miratim ose ndonjë vendim për miratim, ashtu që shërbimet janë kryer jashtë vlerës së lejuar të kontratës e që bie ndesh me legjislacionin në fuqi të prokurimit publik. Në fund, ka theksuar se kreditorit përkundër vështirësive buxhetore, detyrimet e veta i ka kryer sipas kontratës duke ia kompensuar kreditorit vlerën e përgjithshme prej EUR 771,221.44, ashtu që për shumën e kompensuar përtej kontratës, përkatësisht për vlerën prej EUR 71,221.44, do të kërkohet nga kreditori që të kthehet, ose në të kundërtën do të iniciohet procedurë gjyqësore për kthimin e kësaj pjese monetare të paguar përtej vlerës së përcaktuar në kontratë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, ndërsa ka theksuar se kreditori disponon me shkresë zyrtare dhe kërkesë për aprovimin e planit dinamik për ekzekutimin e projektit për periudhën Janar/Dhjetor 2020, pranë Komisionit të Menaxherëve të Kontratës si dhe shkresën “Kthim i përgjegjëse” së datës 30.01.2020 nga Komisioni i Menaxherëve në kuadër të debitorit për aprovimin e planit dinamik të propozuar për periudhën Janar/Dhjetor 2020. Me tej, kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se fatura objekt përmbartimi është lëshuar sipas kontratës dhe sipas miratimit për vazhdimin e projektit dhe mënyrës së situacionit me çmimin njësi nga KRPP dhe pas aprovimit të Planit dinamik për ekzekutimin e projektit për periudhën Janar/Dhjetor 2020 të miratuar nga Menaxheri i Kontratës. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk i përmbush elementet e përcaktuar në LPP-së, ndërsa fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri është lëshuar në zbatim të kontratës publike

kornizë me nr. Ref. 203/15/19, e datës 19.09.2019, dhe e njëjta ka fuqinë e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimin, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datë 31.01.2024, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i debitorit, në seancën e mbajtur dëgjimore ka qëndruar në tërësi pranë prapësimin të ushtruar, ndërsa ka shtuar se propozimin dhe urdhrin për përmbarim e kundërshton në tërësi ngase kreditori ka bërë tejkalim të shpenzimet të kryerjes së shërbimeve të pa porositura nga debitori, duke mos informuar në asnjë rast debitorit dhe pa miratim, pëlqim apo ndonjë vendim nga debitori. Poashtu, ka theksuar se nga ana e kreditorit janë kryer shërbime jashtë vlerës së kontratës së lidhur mes palëve duke rënë ndesh me legjislacionin në fuqi. Në fund, ka theksuar se shuma e cila kërkohet për përmbushje është rezultat i tejkalimit të vlerës së kontratës bazë e cila ishte në lartësi prej EUR 700,000.00 dhe atë pa miratim paraprak nga debitori, ndërsa gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta pranoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të anulohet.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në seancën e mbajtur dëgjimore ka qëndruar në tërësi pranë propozimit për përmbarim, ndërsa ka shtuar se procedura është iniciuar në bazë të dokument të besueshëm, faturës nr. 06, e datës 30.03.2020 e cila i përmbush të gjitha tiparet e përmbarueshmërisë në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Ka theksuar se kundërshtimet e paraqitura nga kreditori janë të pabazuara dhe në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së, ngase kundërshtimi i vetëm i debitorit është tejkalimi i vlerës së kontraktuar, mirëpo që debitori nuk ka ofruar dëshmi nëse i njëjti ka kundërshtuar ndonjëherë faturën dhe vlerën e saj. Me tej, ka shtuar se debitori vet ka informuar auditorin e brendshëm i cili a gjetur në raportin e tij se debitori është në obligim ndaj kreditorit në shumën sipas faturës, raport ky i bashkangjitur me parashtresë nga ana e kreditorit. Faktin se debitori është në detyrim ndaj kreditorit sipas faturës në fjalë, e konfirmon edhe shkresa zyrtare e menaxherit të kontratës me nr. 130/22, e datës 03.04.2020, me të cilën është konfirmuar se kreditori ka realizuar aktivitetin sipas situacionit të përshkruar në faturë, e poashtu nga raporti i datës 14.09.2020 i zv. Shefit të divizionit për buxhet dhe financa është paraqitur detyrimi i debitorit ndaj kreditorit dhe konfirmimi mbi pranimit e faturës e cila është

objekt përbarimi. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, ndërsa të obligohet debitorit që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë vlerën prej EUR 204.00 në emër të përgjigjes në prapësim si dhe shumën prej EUR 270.00 në emër të përfaqësimit në seancën dëgjimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (në tekstin e mëtejme: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, paragrafi 3 i nenit 29 të LPP-së, përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anën tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së “*Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se Përbaruesi Privat ka lejuar urdhrin mbi bazën e faturës e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye në secilën prej faturave janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, në to janë emërtuar shërbimet objekt të faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Për më tepër, gjykata gjen se e njëjta faturës derivon nga kontrata publike kornizë me numër të ref. 203/15/19, “Për programin kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore të Republikës së Kosovës, për komuna Pejë, Deçan, Istog dhe Junik, Lot 1”, e lidhur mes palëve, e datës 19.09.2019. Ndërsa, fatura rezulton të jetë dorëzuar me rregull nga ana e kreditorit dhe është pranuar nga debitorit, fakt ky i cili nuk është kontestuar nga ana e debitorit, ndërsa vërtetohet edhe provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, përkatësisht nga shkresa e datës 04.06.2020, e zëvendës shefes së Divizionit për Buxhet dhe Financa në kuadër të debitorit, drejtuar Drejtorit

të Thesarit, përmes së cilës ka kërkuar alokimin e mjeteve financiare me qëllim të përmbushjes së faturës së pranuar nga kreditorit në vlerë prej EUR 101,052.21.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në fjalë i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në kopje të vërtetuar së bashku me propozimin për përmbartim.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se kreditori ka kryer shërbime pa pëlqim, miratim apo vendim të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase nga shkresat e lëndës, përkatësisht shkresa mbi aprovimin e planit dinamik e datës 30.01.2020 e lëshuar nga Komisioni – Menaxherët e kontratës në kuadër të debitorit, rezulton se kryerja e punëve është bërë me pëlqimin me pëlqimin e këtij komisioni, ndërsa përmes shkresës së datës 03.04.2020, nga i njëjti komision është konfirmuar se kreditori ka realizuar aktivitetet sipas specifikimeve teknike të përshkruara në dosje të tenderit në vlerë prej EUR 101,052.210.

Poashtu, gjykata mori parasysh pretendimet e debitorit se shërbimet janë kryer jashtë vlerës së lejuar në kontratën bazë dhe se debitori ka pranuar mjete më tepër se çmimi i parashikuar i kontratës, rrethanë kjo që bie ndesh me legjislacionin në fuqi të prokurimit publik, mirëpo gjykata nuk u lëshuar në vlerësimin e pretendimeve të tilla, ngase procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit gjykata nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e rrethanave të tjera, përjashtimisht vlerësimin të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së. Megjithatë, gjykata rikujton se vendosja në këtë çështje përmbartimore nuk e paragjkon të drejtën e palës debitore që, lidhur me pretendimet e tilla, të inicioj proces të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Gjykata, ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ndërsa, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi në mbështetje të dispozitave nga neni 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet kreditorit, dhe atë shumën prej EUR 270.00 në emër të përfaqësimit në seancën e mbajtur dëgjimore përmes avokatit si përfaqësues i autorizuar i kreditorit, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 523/22, datë 05.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.